

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
KOMUNËN QENDËR-TOMIN DIBËR

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Komunën Qendër-Tomin, Dibër**, me objekt: *“Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare”*, lloji i auditimit: *“Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare”*, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2011 deri 31.12.2013 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 42, datë 30.04.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 *“Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”*, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 164/6, datë 30.04.2014, i ka rekomanduar z. Sadik Cena, Kryetar i Komunës Qendër-Tomin, Qarku Dibër, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Nga administrata e Komunës Qendër-Tomin, në zbatim të nenit 3, të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 *“Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”*, të hartohet dhe të miratohet në Këshillin e Komunës, Rregullorja e Brendshme e Komunës *“Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Komunës”*, në mbledhjen më të afërt të saj.

Menjëherë

2. Nga administrata e Komunës Qendër-Tomin, të merren masa në lidhje me zbatimin e procedurave për ngritjen dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar, të hartohet dhe miratohet strategjia e zhvillimit ekonomik e sektorial, lista e menaxhimit të strategjisë së riskut, gjatë hartimit të projekt buxhetit të vitit 2014, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 *“Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”*, manualin e MF për menaxhimin financiar dhe kontrollin, miratuar me urdhrin nr. 8980, datë 15.07.2010.

Menjëherë

3. Nga administrata e Komunës Qendër-Tomin, të merren masa që një nga punonjësit e komunës të ngarkohet me administrimin e Aseteve, për inventarizimin, vlerësimin, marrjen në dorëzim të pronave dhe regjistrimin e tyre në bilancin kontabël, sipas dispozitave të ligjit për kontabilitetin dhe pikave 9,10,11,13,14, të VKM^{së} nr. 500, datë 14.08.2001 *“Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”*.

Brenda datës 30.06.2014

4. Nga Zyra e Financës, të merren masa për krijimin e regjistrit të aktiveve të qëndrueshme, ku të përcaktohen të dhënat e nevojshme për datën e hyrjes apo marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes nga përdorimi, datën e s’kadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale që sjell rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimit të mirëmbajtjes dhe datën e daljes nga pronësia, sipas kërkesave të Kap. III-të –*Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre*, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”*.

Brenda datës 30.06.2014

5. Nga Zyra e Financës, të merren masa për zbatimin e limitit të arkës dhe në fund të çdo muaji të kryhet inventarizimi fizik, në zbatim të nenit 80, Kap IV-Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”*.

Vazhdimisht

6. Zyra e Financës, në bashkëpunim me drejtuesin e institucionit për çdo vit të ngrejë komisionin për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të qëndrueshme, në zbatim me pikën

38, 96, 98 e 100, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe UMB nr. 1151, datë 16.7.2007 “Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit dhe asgjësimit të aktiveve të qëndrueshme dhe qarkulluese në sistemin e Ministrisë Brendshme”.

Vazhdimisht

7. Nga Komuna Qendër-Tomin, të merren masa për hapjen e regjistrimit themeltarë të punonjësve dhe të lidhen kontratat e punës, në zbatim të nenit 12, 21 dhe 95, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995,” Kodi i Punës”, i ndryshuar.

Menjëherë

8. Nga Komuna Qendër-Tomin, të merren masa për hapjen e regjistrimit të parashikimeve dhe të realizimit të prokurimeve, në të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, dhe Kreun I^{rë}, pika 3/d dhe 2, të nenit 12-Përgjegjësia e autoritetit kontraktor, të VKM^{së} nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Brenda datës 30.06.2014

9. Nga Zyra e Taksave, të merren masa për njoftimin e të gjithë abonentët familjarë dhe jo familjarë për detyrimet që ato kanë për taksat e tarifave vendore, në zbatim të nenin 4, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Lokale” me ndryshime dhe nenin 32, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”.

Brenda datës 30.06.2014

10. Zyra e Taksave Vendore në bashkëpunim me Policinë e Komunës, të marrë masa për arkëtimin e taksave nga biznesi i vogël dhe i madh, taksën e pasuri për biznesi dhe për familjet, tarifën e pastrim, taksën e tokës bujqësore, në shumën **4,128,000 lekë**, si mungesë të ardhurash në buxhetin e komunës.

Brenda datës 30.09.2014

11. Nga ana e Komunës Qendër-Tomin, të lidhet marrëveshjen me Këshillin e Qarkut Dibër, për delegimin e kompetencave të Inspektoratit Ndërtimore e Urbanistik, në zbatim të nenit 6, dhe 18, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektoratin e ndërtimit”.

Menjëherë

12. Nga ana e Komunës Qendër-Tomin, të analizohet aktiviteti i Policisë së Komunës dhe të marren masat e menjëhershme për vënien në efikasitet të plotë, në zbatim të nenit 8, të ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997, me ndryshime në ligjin nr. 8335, datë 23.04.1998 “Për Policinë Bashkiake e të Komunës “, si dhe nenin 32, pika 10, dhe 15, pika 2, e urdhrin të përbashkët i Ministrisë të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 1530, datë 07.04.2003 dhe Ministrisë të Rendit Publik nr. 823, datë 11.04.2003 “Për miratimin e rregullores “TIP, të policisë bashkiake dhe të Komunës”.

Menjëherë

13. Nga Policia e Komunës të merren masat për njohjen dhe vënien në zbatim të ligjit nr. 8224, datë 15/5/1997, me ndryshime në ligjin nr. 8335, datë 23.04.1998, si dhe urdhrin e përbashkët të Ministrisë të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 1530, datë 07.04.2003.

Vazhdimisht

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, Kreu I, nenet 105-109 dhe Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kapitulli IV–Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 93, **nga titullari i njësive publike** (Nëpunësit Autorizues) të nxirren aktet administrative, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në vlerën **675,259 lekë**, në mënyrë analitike si më poshtë:

1 Vlera prej 10,624, në ngarkim të 2 punonjës, për përfitim të padrejtë të pagës për periudhën 01.01.2011 – 30.04.2011, respektivisht: D.K. në vlerën **5,312 lekë** dhe Q.K. në

vlerën **5,312 lekë**, pagesa këto në kundërshtim me VKM nr. 598, datë 27.04.2009, VKM nr. 693, datë 18.08.2010, VKM nr. 553, datë 11.08.2011 dhe VKM nr. 518, datë 16.08.2012 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 1619, datë 02.07.2008 të KM “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore”.

Brenda datës 30.06.2014

2. Vlera prej 180,000 lekë, në ngarkim të Kryetarit të Komunës S.C. në kryerjen e pagesave për shpenzime të telefonisë celulare, në kundërshtim me pikën 2, 9 dhe 10, të VKM nr. 864, datë 23.07.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridik publik”.

Brenda datës 30.09.2014

3. Vlera prej 173,072 lekë, për pagesën e kryer ndajë 2 punonjësve, respektivisht A.K. në vlerën **140,072 lekë** dhe A.K. në vlerën **33,000 lekë**, pagesa këto në kundërshtim me pikën 1, germa “a” dhe pika 3, të Vendimin e KM nr. 463, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në VKM nr. 511, datë 24.10.2002 të KM “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucion shtetëror”, të ndryshuar.

Brenda datës 30.09.2014

4. Vlera 33,963 lekë, në ngarkim të 3 anëtarëve të KVO nga **11,321 lekë** secili, përkatësisht Z.M. në cilësinë e kryetarit të KVO, B.K. dhe Q.T., në cilësinë e anëtarit të KVO.

Për dëmin ekonomik të shkaktuar si rezultat i s’kualifikimit (me çmim më të ulët), të operatorit ekonomik “M...” ShPK me vlerë oferte prej 850,499 lekë dhe shpalljes fitues të operatorit ekonomik “A...O.” ShPK me vlerë oferte prej 884,461 lekë, për tenderin e zhvilluar me objekt “Ndërtim depo uji 40 m³ në fshatin Çetush”, veprim në kundërshtim me nenin 1, germa “b”, dhe neni 55, i ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

Brenda datës 30.06.2014

5. Vlera prej 137,800 lekë, në ngarkim të subjektit “A...-E...”, për përfitimin padrejtësisht të TVSH^{-5ë} të mallit të shitur pa faturë TVSH^{-je} dhe pa qenë subjekt i regjistruar për TVSH, në kundërshtim me nenin 49, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, i ndryshuar, dhe nenit 33, pika 3, e ligjit nr. 7928, datë 24.04.1995 “Për TVSH^{-në}”.

Brenda datës 30.06 .2014

6. Vlera prej 139,800 lekë, në ngarkim të 2 punonjësve, respektivisht S.C. me detyrë Kryetar i Komunës për vlerën **69,900 lekë** dhe H.T. me detyrë punonjës hidraulik për vlerën **69.900 lekë**, për kryerjen e prokurimeve në sasi malli më të madhe se vlera e preventivit të objektit, pagesa këto në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr. 1, datë 20.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe për mos argumentim të shpenzimeve të mallit me dokumentacion, në kundërshtim me nenin 13, pika “ç”, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “ Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Brenda datës 30.06 .2014

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 44, të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” dhe nenit 144, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i rekomandojmë Kryetarit të Komunës Qendër-Tomin, Qarku Dibër, që të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore, **për 10 punonjës** si më poshtë:

“Vërejte me paralajmërim për zqjdhjen e kontratës së punës”.

1. D.K. me detyrë Përgjegjëse e Zyrës së Financës, si dhe në cilësinë e kryetarit të komisionit të prokurimit me vlera të vogla, për;

- mos zbatim të dispozitave ligjore të ligjit nr. 10296, datë 008.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”;
- mos hartimin dhe miratimin e buxhetit, veprime në kundërshtim me nenin 32, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”;
- mos zbatim të procedurave për blerjeve me vlerë të vogël për periudhën e vitit 2012 dhe 2013, veprime në kundërshtim me neni 29, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Kreu VI, pika 2 dhe 5, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe të Udhëzimit të KM nr. 2, datë 18.02.2008 “Për procedurat e prokurimit me vlera të vogla”, i ndryshuar.

2. E.K. me detyrë Përgjegjës i Zyrës së Taksave Vendore, si dhe në cilësinë e anëtarit të komisionit të prokurimit me vlera të vogla, për;

- mos njoftim të abonentëve familjarë dhe jo familjarë, mbi detyrimet për taksat e tarifatat vendore, në kundërshtim me nenin 4, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Lokale”, i ndryshuar, dhe nenit 32, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, me ndryshime.
- mos zbatim të procedurave të parashikuara në Kreu XI-*Mbledhja me forcë e detyrimeve të papaguara*, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, me ndryshime, pikat 3 dhe 5, të udhëzimit përbashkët të Ministrisë së Financave dhe pikat 4, nënpikat 4.1.4.3, pikat 5, 6, 8 dhe 9, të MPVD nr. 5, datë 27.01.2003, si dhe nenet 17 dhe 34, shkronja “a”, pika 3, e udhëzimit të MF nr. 655/1, datë 06.02.2007 “Për përcaktimin e uniformitetit të Standardeve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksës vendore”, për arkëtimin e detyrimeve të subjekteve fizik dhe juridik.
- mos zbatim të procedurave për blerjeve me vlerë të vogël për periudhën e vitit 2012 dhe 2013, veprime në kundërshtim me neni 29, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Kreu VI, pika 2 dhe 5, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe të Udhëzimit të KM nr. 2, datë 18.02.2008 “Për procedurat e prokurimit me vlera të vogla”, i ndryshuar.

3. Q.T. me detyrë Përgjegjëse e Zyrës së Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës, për;

- shkeljet e konstatuara në administrimin e pronave, inventarizimin, regjistrimin pranë ZVRPP Dibër, vlerësimin dhe zbatimin e një plani menaxhimi e mbarështimi në asetet e qëndrueshme, veprim në kundërshtim, me kërkesat e përcaktuara në VKM nr. 500, datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin në njësitë e qeverisjes vendore”, pikat 3, 4 e në vijim të VKM nr. 22, datë 9.01.2008, “Për përcaktimin e procedurave dhe të Kriteve të Administrimit të Pyllit Komunal”.

4. M.Is. me detyrë punonjës i Policisë së Komunës.

5. A.V. me detyrë punonjës i Policisë së Komunës

- Për shkeljet e konstatuara në dokumentimin e punës së Policisë së Komunës dhe mos vendosjen e gjobave në kontrollet e ushtruara sipas kërkesave ligjore të përcaktuara në nenin 8, të ligjit nr. 8224, datë 15.5.1997 “Për organizimin dhe Funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës”, me ndryshime.

6. R.V. me detyrë ish Sekretar i Kryetarit dhe arshivist.

7. E.D. inspektor i ndihmës ekonomike.

8. M. D. inspektor i ndihmës ekonomike.

9. A.V. me detyrë punonjës i Policisë së Komunës.

10. H. T. me detyrë punonjës hidraulik, për;

- mos zbatim të procedurave për blerjeve me vlerë të vogël për periudhën e vitit 2012 dhe 2013, veprime në kundërshtim me neni 29, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Kreu VI, pika 2 dhe 5, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe të Udhëzimit të KM nr. 2, datë 18.02.2008 “Për procedurat e prokurimit me vlera të vogla”, i ndryshuar.

Nga Komuna Qendër-Tomin, Qarku Dibër me shkresë nr.180, prot, datë 19.05.2014, protokolluar në KLSH me nr.164/7 datë 22.05.2014, është kthyer përgjigje së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë pranuar dhe zbatuar pjesërisht.**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit Hysen Metko, Kristaq Gjurgjaj dhe Ryisim Xhaja, më tej u shqyrtua nga z. Fatmir Zilja kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, Kontrollit të Cilësisë dhe Analizës së Riskut, si dhe u verifikua si praktikë nga znj. Helga Vukaj, Drejtor i Përgjithshëm.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT